

# Abortin MEDIKAMENTOZ




ІЗУ УК  
Гинекологія  
и акушерство



A Member Association of



**IPPF** International  
Planned Parenthood  
Federation  
European Network



# Çfarë duhet të dish për abortin medikamentoz?



Gratë vendosin për abortin për shumë arsye.

Vendimi yt është i vërtetë nëse për këtë vendos ti, pa u përzier dikush tjetër.

## **Për shëndetin tënd vendos ti vetë.**

Para se të vendosësh nëse do të kryesh abort ose jo, ndoshta do të ndihmojë biseda me ndonjë të afërm nga familja ose me ndonjë mikeshë. Edhe në klinikë ju qëndrojmë në dispozicion për informacion dhe mbështetje në çdo kohë.



Abortin medikamentoz mund kryesh në klinikën tonë deri në javën e 22-të të shtatzënisë. Pas javës së 22-të, ndërprerja e shtatzënisë mund të bëhet vetëm me pëlqimin e komisionit në klinikë, dhe kjo vetëm nëse është e rrezikshme për shëndetin dhe jetën tuaj.

### **Mos u brengos, aborti medikamentoz është i sigurt.**

Në këtë broshurë do t'i gjesh përgjigjet për pyetjet më të shpeshta që gratë i kanë kur vendosin të bëjnë abort medikamentoz. Përmes broshurës do të kuptosh si kryhet aborti medikamentoz, çarë duhet të presësh nga procedura në javët në vijim dhe kur është e nevojshme të paraqitesh për ndihmë ose mbështetje nga ekipi ynë mjekësor.

# Pse gratë vendosin për abort medikamentoz?

Gratë e zgjedhin abortin medikamentoz pasi që e ndjejnë më intim për trupin e tyre, për dallim nga intervenimi kirurgjik. Kjo mënyrë e abortit nuk realizohet me instrumente mjekësore, por me pilula të cilat gruaja i merr me rekomandim të gjinekologut.

Gjëja e mirë për abortin medikamentoz është se ju nuk duhet të jeni të shtrirë në spital nëse aborti kryhet deri në javën e 12-të të shtatzënisë. Plus, do të jeni në gjendje të ktheheni në punë ose të bëni obligimet e shtëpisë që ditën tjetër ose për një ose dy ditë.



# Sa është efikas aborti medikamentoz?


**Aborti medikamentoz është përdorur me sukses që nga viti 1990** në shumë vende si një metodë alternative e abortit kirurgjik. Efikasiteti i tij është nga 95% në 97% dhe vetëm në një numër të vogël të rasteve nevojitet ndërhyrje mjekësore shtesë. Organizata Botërore e Shëndetësisë gjithashtu e rekomandon abortin medikamentoz si të sigurt. Komplikimet janë të mundshme, por praktika tregon se ato janë të vogla dhe zgjidhen lehtë.



# Çfarë ekzaminimesh do të më bëhen para abortit medikamentoz?



Pasi të keni vendosur për një abort medikamentoz, gjinekologu ose infermierja së pari do t'ju presin në një dhomë të klinikës, që është e posaçme për këtë shërbim. Këtu do të merrni të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me abortin medikamentoz. Nëse jeni në tremujorin e parë të shtatzënisë, vizita në klinikë nuk do të zgjasë më shumë se 2 orë. Nëse jeni më shumë se 12 javë shtatzënë, do të duhet të shtroheni në spital për disa ditë.

An illustration of a doctor in a white coat and a patient with red hair. Above them is a large teal thought bubble containing several question marks of different colors (white, pink, orange, dark blue).

Në fillim, mjeku do t'ju parashtrojë disa pyetje që të merren të dhënat e vlefshme për këtë procedurë:

- \* Kur e keni pasur menstruacionin e fundit?
- \* Nëse ju ose dikush tjetër nga familja është i sëmurë nga ndonjë sëmundje kronike?
- \* A përdorni ndonjë ilaç?
- \* A jeni alergjike ndaj ndonjë ilaçi?
- \* A keni shumë gjakderdhje gjatë ciklit menstrual?
- \* A keni pasur paraprakisht abort ose ndonjë operacion gjinekologjik?
- \* A keni simptoma të ndonjë infektimi seksualisht të transmetueshëm?
- \* Nëse dhe çfarë lloji të kontracepsioni përdorni?



Varësisht nga përgjigjet ndaj këtyre pyetjeve, mjeku juaj do të dijë nëse një abort medikamentoz mund të kryhet në rastin tuaj. Nëse nuk i plotësoni kushtet për një abort medikamentoz, do t'ju rekomandohet të bëni një abort kirurgjik.

Pas vlerësimit të gjendjes tuaj shëndetësore, gjinekologu do të bëjë një ekzaminim EHO për të konfirmuar shtatzëninë, por edhe për të përcaktuar javën e saktë të shtatzënisë. Nga kjo varet numri i pilulave që ai do t'ju përshkruajë në mënyrë që aborti medikamentoz të mund të kryhet me sukses. Do të bëhet edhe një pasqyrë gjaku për të marrë të dhëna për hemoglobinën, vlera e të cilave është e rëndësishme të monitorohet gjatë procedurës.



## Si kryhet aborti medikamentoz?

Së pari, mjeku juaj do t'ju japë **një pilulë** të quajtur **Mifepriston**. Këtë tabletë do ta merrni në klinikë. Ai do t'ju japë **4 tableta** të tjera **për në shtëpi**, të quajtura **Mizoprostol**, të cilat do **t'ju duhet të merrni 24 orë pas marrjes së pilulës së parë në klinikë**. Për shembull, nëse keni marrë pilulën tuaj të parë në orën 10 të mëngjesit në klinikë, do të duhet të merrni tableta Mizoprostol në të njëjtën kohë të nesërmen. Këto 4 pilula duhet t'i merrni jo më vonë se 48 orë pas marrjes së pilulës në klinikë, sipas skemës së përshkruar nga gjinekologu juaj për në shtëpi.





Kur të arrini në klinikë, vishni rroba të lehta dhe merrni peceta higjienike që thithin lëngun mirë. Këshilla jonë është të vini në klinikë me një shoqërues - një anëtar i familjes ose një mikeshë - për t'ju dërguar në shtëpi të sigurt pas procedurës.

Pas largimit nga klinika, do të merrni pilula kundër dhimbjes dhe temperaturës. Ato do t'ju zvogëlojnë dhimbjen nga ngërçet që ndodhin pas marrjes së pilulës së dytë (Mizoprostol). Mjeku ose infermierja juaj do t'ju japë gjithashtu pilula kundër vjelljes, si dhe një numër telefoni për një konsultë.

Pasi të largoheni, mbani në mend se mund të lëvizni lirshëm, por përsëri është më mirë të qëndroni në shtëpi dhe të mos dilni për disa ditë. Prisni që dikush nga mjekët ose infermierja nga klinika t'ju telefonojë po atë ditë ose ditën tjetër për t'ju pyetur si ndiheni.

# Çfarë mund të pres

se do të ndodhë në ditët në vijim?

## Gjakderdhje


Tabletat që do t'i pini në shtëpi (Mizoprostol) shkaktajnë ngërçe barku dhe gjakderdhje. Shumë shpesh kjo shoqërohet me pjesë të mpiksjes së gjakut. Gjakderdhja dhe ngërçet e barkut gjatë një aborti

medikamentoz janë më të theksuara sesa dhimbja që ndoshta jeni mësuar gjatë ciklit tuaj menstrual. Ngërçet zakonisht ndodhin 2 deri në 3 orë pas marrjes së dozës së dytë të pilulave (Mizoprostol) dhe mund të zgjasin deri në 5 orë. **Edhe**

**pse mund të rrjedh gjak më shumë se zakonisht, dije se nuk është e rrezikshme.** Kjo do të thotë që pilulat funksionojnë. Ju mund të vini re se po derdhni copa më të mëdha gjaku, por mos u shqetësoni - kjo është mjaft e zakonshme për një abort medikamentoz. Ju do të ndjeni gjakderdhjen më të rëndë pas abortit, por dijeni se gjakderdhja mund të vazhdojë për dy javët e ardhshme. Gjakderdhja mund të ndalet herë pas here dhe pastaj të vazhdojë deri në periudhën tjetër menstruale. **Përdorni peceta higjienike që thithin mirë. Mos përdorni tamponë.**

## Ngërçe

Ju mund të përjetoni më shumë dhimbje dhe ngërçe barku nga sa jeni mësuar gjatë cilit tuaj menstrual. Nëse dhimbja është e padurueshme, merrni pilulat që ju janë dhënë në klinikë. Ju gjithashtu mund të përdorni leckat të ngrohta në bark për të zvogëluar dhimbjen. Disa gra mund të përjetojnë gërditje, të vjella ose ethe gjatë 2-3 ditëve të ardhshme pas marrjes së dozës së dytë të pilulës (Mizoprostol). **Kjo mund të jetë e pakëndshme, por nuk është e rrezikshme dhe nuk do të thotë se diçka e keqe po ndodh.**



# Kur duhet të paraqitem në klinikë ose të kërkoj ndihmë?



Nëse gjakderdhja bëhet shumë e rëndë (për shembull, nëse ndërroni 2 deri në 3 peceta higjienike çdo orë për 2 orë rresht) ose zgjat më shumë se 5 ditë, telefononi në numrin e telefonit që ju është dhënë në klinikë. E njëjta gjë vlen nëse dhimbja dhe temperatura e lartë nuk kalojnë me qetësuesit e dhimbjeve ose nëse pas 2-3 ditësh përsëri ndjeni të përzier dhe të vjella.

Gjinekologu do të dijë nëse këto komplikime janë më serioze dhe nëse do të duhet të shkoni në klinikë sa më shpejt të jetë e mundur.



# Kur duhet të shkoj për kontroll?

Kontrollimi do të caktohet 2 javë pas abortit medikamentoz. Me një ekzaminim EHO, gjinekologu do të përcaktojë nëse aborti ka përfunduar me sukses. Nëse shtatzënia nuk ndërpritet plotësisht (gjë që ndodh vetëm në 2-3% të rasteve), do t'ju jepet një dozë e re Mizoprostol ose do të bëni një abort kirurgjik.

Gjatë ekzaminimit pasues, do t'ju bëhet përsëri pasqyrë gjaku për të kontrolluar vlerën e hemoglobinës. Ju gjithashtu do të flisni me gjinekologun tuaj për metodat kontraceptive që mund të përdorni pas një aborti për të parandaluar shtatzënitë e paplanifikuara në të ardhmen.






# Sa gjatë do të mungoj

## nga puna nëse vendos për abort medikamentoz?

Nëse vendosni të bëni një abort mjekësor deri në javën e 12-të të shtatzënisë, atëherë mund të ktheheni në obligimet tuaja ditore një ose dy ditë pas procedurës. Pas javës së 12-të të shtatzënisë, duhet të shtroheni në spital për të kryer një abort medikamentoz. Pra, kur do të mund të ktheheni në obligimet tuaja të përditshme do të varet nga vlerësimi i mjekut tuaj dhe shëndeti juaj.



# Nëse dhe çfarë kontracesioni mund të përdor pas abortit medikamentoz?

Kontracesioni është shumë i rëndësishëm për të parandaluar shtatzëninë e paplanifikuar në të ardhmen. Shumë gra bëhen pjellore dhe mund të mbeten shtatzënë menjëherë pas një aborti.

Nëse jeni duke përdorur kontrceptivë oralë, do të jeni në gjendje të vazhdoni ta merrni atë nga e njëjta ditë kur merrni dozën tuaj të dytë të pilulave (Mizoprostol). Një tjetër mundësi është DIU, e cila mund të futet një javë pas përfundimit të abortit mjekësor.





Metodat natyrale kontraceptive, të tilla si numërimi i ditëve pjellore / jopjellore, mund të përdoren pasi të vendoset cikli juaj i rregullt menstrual. Ju mund të përdorni një prezervativ sapa të filloni të keni aktivitet seksual. Për të shmangur rrezikun e infektimit, është më mirë të abstenoni nga marrëdhëniet seksuale për 3 javët e ardhshme pas abortit.

[www.hera.org.mk](http://www.hera.org.mk)